

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tentativë vrasjeje, drogë dhe municion luftarak, arrestohen në Itali dy shqiptarë - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/tentative-vrasjeje-droge-dhe-municion-luftarak-arrestohen-ne-itali-dy-shqiptare/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:59:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:57:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d2c992a00c928adf35a2ec153daf78c03228a1a03520a1ecd1d44c4a028b31e0
TEKSTI	2033e31a1b57ddb4f73c0ed171377c0717ba79068a7b8472c1430fb9cc4ed5c5
PAMJA	e84669e2d4d35d0d5550842cc4cba0da8a7457830242248bf4fa9184d0e0d0d2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a58e23d4956e989c189f681d3a4a14329dfa6022604b71e534102d8fd33cb547
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a58e23d4956e989c189f681d3a4a14329dfa6022604b71e534102d8fd33cb547>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Tentativë vrasjeje, drogë dhe municion luftarak, arrestohen në Itali dy shqiptarë

by Sport Sport — September 18, 2026 in Aktualitet, Kronikë

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Dy shqiptarë të shpallur në kërkim ndërkombëtar janë arrestuar në Itali në kuadër të dy fazave të reja të operacionit të koduar "The Wanted".

Njëri prej të arrestuarve, Muhamet Bedulla, 33 vjeç, është dënuar me 10 vite burg për vrasje me dashje të mbetur në tentativë. Sipas Policisë së Shtetit, në vitin 2017 ai plagosi tre herë me thikë një person me të cilin ishte konfliktuar.

Në pranga ka rënë edhe U. B., 26 vjeç, ndaj të cilit Gjykata e Elbasanit ka caktuar masën "Arrest në burg" për shitje narkotikësh dhe posedim të paligjshëm të municionit luftarak. Autoritetet shqiptare dhe italiane vijnë procedurat për ekstradimin e dy të arrestuarve drejt Shqipërisë.

"Në vijim të bashkëpunimit të ngushtë me partnerët italianë, konkretizuar nëpërmjet koordinimit operacional dhe informativ ndërmjet specialistëve të Drejtorisë së Interpolit dhe homologëve të Interpol Romës, u finalizuan 2 faza të tjera të operacionit të koduar "The Wanted", të cilat rezultuan me arrestimin në Itali, me qëllim ekstradimin në Shqipëri, të 2 shtetasve të shpallur në kërkim ndërkombëtar.

Konkretisht, u arrestuan shtetasit:

-Muhamet Bedulla, 33 vjeç, të cilin Gjykata e Korçës, në vitin 2018, e ka dënuar me 10 vjet burgim, për veprën penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë. Në vitin 2017, ky shtetas ka tentuar të vrasë shtetasin A. S. (babai i shtetasit me të cilin ishte konfliktuar në Korçë), të cilin e ka plagosur tri herë me mjet prerës (thikë). Nga dënimi 33-vjeçarit i kanë mbetur për të vuajtur 3 vjet dhe 4 muaj burgim;

-U. B., 26 vjeç, të cilin Gjykata e Elbasanit, në vitin 2025, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit". Në vitin 2024, shtetasi U. B. është kapur duke shitur lëndë narkotike Cannabis Sativa, dhe akuzohet se ka mbajtur në banesë, sasi të konsiderueshme fishekësh luftarakë dhe 2 krehra pistolete."- njofton policia.

Interpol Tirana dhe Interpol Roma vijnë të bashkëpunojnë për të finalizuar procedurat për ekstradimin e të dy shtetasve, në Shqipëri.

TË FUNDIT

Tentativë vrasjeje, drogë dhe municion luftarak, arrestohen në Itali dy shqiptarë

SEPTEMBER 18, 2026

Ndizen tensionet në Prishtinë para nisjes së protestës/ Policia kërkon dokumentet e identifikimit të pjesëmarrësve, qytetarët kundërshtojnë

SEPTEMBER 18, 2026

U miratua vetëm me votat e PS, Presidenti Begaj dekreton ligjin për pagat e Magjistratëve

SEPTEMBER 18, 2026

Përfshihet nga flakët automjeti në një parkim nëntokësor në Fier, banorët në panik

SEPTEMBER 18, 2026

Tabaku i kujton Ramës 110 ditë protesta: Provo dil, të tërheqin zvarrë! Mos trego arrogancë, por jep dorëheqjen

SEPTEMBER 18, 2026

"O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke"/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit

SEPTEMBER 18, 2026

Shqipëria e dyta në Europë për vështirësitë e jetesës/ Gjysma e shqiptarëve mezi mbyllin muajin

SEPTEMBER 18, 2026

Plagosja e avokatit në Durrës, bojkotohen për dy orë seancat gjyqësore

SEPTEMBER 18, 2026

Veteranët e UÇK organizojnë sot protestë në Prishtinë, policia shton masat e sigurisë

SEPTEMBER 18, 2026

Lirohen 25 protestuesit që u ndaluan gjatë tensioneve para Parlamentit, procedohen në gjendje të lirë

SEPTEMBER 18, 2026

Previous Post

Ndizen tensionet në Prishtinë para nisjes së

protestës/ Policia kërkon dokumentet e identifikimit të pjesëmarrësve, qytetarët kundërshtojnë



Sport Sport

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencja dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.